


Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherit të Prokurimit: “Qendra Klinike Universitare e Kosovës”.	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP
Prej:	Visar BIBAJ - Ekspert shqyrtues 		
Lënda:	Raporti lidhur me Ankesen nr. 53/17, parashtruar nga OE “Ledi Med” - Prishtinë		
Datë:	13.03.2017.		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 05/L-068, dhe Ligjin Nr. 05/L-092, për Prokurim Publik, ju njoftojmë me raportin e ekspertizës, lidhur me ankesat e parashtruara me dt. 23.02.2017, nga OE “Ledi Med” – Prishtinë, kundër AK - Qendra Klinike Universitare e Kosovës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Servisimi dhe mirëmbajtja e rregullt e paisjeve radiologjike - lot 1,2,3,6 dhe 7”, me nr. të Prokurimit: 701/16/097/211.

AK, është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur me këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.


Ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues - “Qendra Klinike Universitare e Kosovës”.
- Panelit Shqyrtues - “OSHP”.
- OE - ankues - “Ledi Med” - Prishine



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

	01.03.2017	06.07.2017	13.03.2017
<i>Nënshkrimi i ekspertit</i>	<i>Data e autorizimit të eksp.</i>	<i>Data e fillimit të ekspertizës</i>	<i>Data e dorëzimit të raportit</i>

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën **23.02.2017**, Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka pranuar ankesën me nr. **53/17**, parashtruar nga OE **“Ledi Med” sh.p.k**, me seli në **Prishtinë**, kundër **AK - Qendra Klinike Universitare e Kosovës**, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **“Servisimi dhe mirëmbajtja e rregullt e paisjeve radiologjike - lot 1,2,3,6 dhe 7”**, me nr. të Prokurimit: **701/16/097/211**.

Konform nenit 113.1, të LPP-së Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068, dhe Ligjin Nr. 05/L-092, eksperti shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar lëndën e (AK) – **Qendra Klinike Universitare e Kosovës**.

N.111,LPP - Operatori Ekonomik Ankues , “Ledi Med” sh.p.k - Prishtinë.

Pikat e Ankesës nga OE **“Ledi Med” sh.p.k**, me seli në **Prishtinë**, dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues.

- - Neni 6, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
- - Neni 7, Barazia në trajtim/Jo-diskriminim,
- - Neni 41- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve i udhezuesit operativ per prokurim publik –
- - Neni 59, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i tenderëve;
- - Neni 72, per sqarime shtese

Raporti i ekspertit shqyrtues për lëndën: “Servisimi dhe mirëmbajtja e rregullt e paisjeve radiologjike Lot 1,2,3,6 dhe 7”, me nr. të Prokurimit: 701/16/097/211, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – “Qendra Klinike Universitare e Kosovës.



Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Të nderuar AK- QKUK, me eliminimin e ofertës tonë nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në këtë aktivitet të prokurimit, gjatë RI-VLERËSIMIT, ka bërë shkelje ligjore dhe nuk ka respektuar Vendimin e OSHP-së, Vendimi nr. 402/16 i datës 20.01.2017. OSHP-ja në këtë Vendim ka kërkuar si më poshtë.

- **Anulohet, vendimi i autoritetit kontraktues - Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK) për dhenie të kontratës, lidhur me procedurën e prokurimit me titull "Servisini dhe mirëmbajtje e rregullt e pajisjeve radiologjike Lot 1,2,3,6 dhe 7, me nr të prokurimit: 701/16/097/211, dhe lenda kthehet në rivlerësim.**

- **Obligohet AK që me rastin e ri-vlerësimit të veproj konform nenit 72 lidhur me referencat e OE ankues "Ledi Med".**

AK në këtë rast, nuk ka vepruar konform LPP-së, Neni 72,

- Rasti i Parë, "Letër Reference" nga QKMS, nuk është kërkuar fare më sqarim pas Vendimit të OSHP-së, në letren eliminuese që na ka dërguar, ka cekur se sipas Vendimit të OSHP-së kemi marr një konfirmim nga QKMS me datë 19.01.2017, ndërsa në të vertet Vendimi i OSHP-së që ka kërkuar Ri-vlerësim, është lëshuar me datë 20.01.2017, AK-QKUK nuk ka ndërmarr më kurrfar veprimi që konform nenit 72 të kërkoj sqarim shtesë lidhur me këtë "Letër Referenc", por i është referuar korrespondencave të mëhershme, që kanë qënë para datës së lshimit të vendimit të OSHP-së.

Edhe pse për këtë rast, AK-QKUK ka pasur dëshmi të njajtueshme se Letra në fjalë është origjinale dhe nuk ka pasur falsifikim apo mashtrim, kjo është dëshmuar edhe nga organet kompetente, organe këto në të cilat vetë AK-QKUK, u është drejtuar, Policia e Kosovës, Njësia e Krimeve Ekonomike, ka kryer hetime, në të cilat jemi thirrur edhe ne dhe dëshmitarë të tjerë, dhe lënda ka shkuar në Prokurorin Themelore të Kosovës, e cila edhe ka dëshmuar se nuk ka pasur shkelje apo mashtrim, "SHËNIMIN ZYRTAR" të lëshuar nga Prokuroria Themelore e Kosovës të cilin e kanë marr edhe më heret, e ne jau kemi dërguar edhe me kërkesën për Rishqyrtim, prap kjo nuk është marrë parasysh.

Përveq kësaj, ne me datë 15.02.2017 i jemi drejtuar Zt. Shkelzen Rexhaj, (në cc kemi futur edhe emailin e Zt. Gazmend Rushiti - Zyra e Prokurimit QKUK), i cili në kohën kur na është lëshuar kjo letër Reference, ka qënë Drejtor i Qëndres, dhe kemi marr përgjigjen si më poshtë:

Te nderuar, Në baze të kërkeses tuaj, emaili i datës 15.02.2017. ju sqarojmë si ne vijim:

Siq e kam cekur edhe në shkresat paraprake lidhur me këtë qështje, kompania "Ledi Med", ka kryer shërbime dhe furnizime të ndryshme për Qëndren tonë, sipas kontratave me MSH, mes tyre është edhe shërbimi që iu keni cekur "Servisini i Paisjeve në OMRS" me ref Nr. 206-12-088-236.

Shkresa - "Referenca" të cilën ma keni dërguar kopje të kësaj email, e njejtë më është prezentuar edhe nga organet e hetuesisë, andaj siq jam deklaruar në hetuesi edhe tani konfirmoj se "Shkresa - Referenca" në fjalë për projektin e cekur më lartë, është lëshuar nga Qendra jonë

Për qfaredo paqartësie lidhur me këtë, mund të na kontaktoni.

Shkelzen Rexhaj

SHSKUK

Qendra Kombëtare e Mjekësisë Sportive – QKMS

Pallati i Rinisë dhe Sporteve

Pristia/Kosova

Tel/Ft. 038 225 075

Mob:--377 44 199 901

E-mail: shkelzer rexhaj@hotmail.com

Raporti i ekspertit shqyrtues për lëndën: "Servisini dhe mirëmbajtja e rregullt e pajisjeve radiologjike Lot 1,2,3,6 dhe 7", me nr. të Prokurimit: 701/16/097/211, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – "Qendra Klinike Universitare e Kosovës.

D.m.th. edhe njeherë konfirmon se Letra në fjalë është lëshuar nga kjo Qënder;

- Rasti tjetër, lidhur me Letër Reference dhe Raportin e Pranimi nga Spitali EUROMED, ne duke parë se AK-QKUK, ka neglizhuar lidhur me këtë, ose emaili i tyre ka shkuar në ndonjë adres të papërdorëshme, me datë 14.02.2017 i kemi drejtuar një email Sp. EUROMED, në cc kemi futur edhe emailin e Zt. Gazmend Rushiti - Zyra e Prokurimit QKUK, dhe i njeiti na është përgjigjur si më poshtë:

Te nderuar

Z. Rushiti - OKUK,

Z. Alushaj - Ledi MEDshpk,

Ne kemi pranuar e-mail nga Ledi MED Shpk, lidhur me ate se ne na eshte derguar email nga OKUK, ju njoftojme se ne nuk kemi pranuar asnje email nga OKUK lidhur me kete qeshije,

Ne i shikuam dokumentet qe jane cekur dhe ju konfirmojme, se te dy letrat jane te leshuara nga ne, si Leter Referenca ashtu edhe Raporti,

Per cfaredo sqarimi ju lutem na kontaktoni,

Gjithe te mirat,

Leart Jakupi

CEO

Klinika Euromed shp

Rr: Nena Tereze 158

Prishtine - Fushe Kosove - km3

Tel +37744999944

Web. www.spitalieuromed.com

Lidhur me atë se raporti i Pranimi është letër e brendshme - interne e Spitalit, ju Sqarojm se në dosje të tenderit, tek Kërkeszgj azj aziadësitë teknike dhe/ose profesionale, ka qënë e kërkuar, citojm tek pika 4-(ii);

4. Dëshmi se OE ka perfunduar me sukses minimum dy kontrata te natyrës së njejtë në tri vitet e fundit. 2013, 2014 dhe 2015.

4. Listën me të cilën specifikohen të gjitha Sherbimet kryesore të rëndësishme të operatorit ekonomik të realizuara në tri vitet e shkuara, duke saktësuar Sherbimet e Ofruara, shumën e kontratës, datën dhe pranuesit, (i) kur sherbimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi shërben kopja e certifikatës (certifikatave) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkë nënshkruara nga autoriteti i tillë, (ii) kur Sherbimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij Sherbimi shërben kopja e cdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i Sherrbimit të tillë:

Te dyja emailat konfirmuese po i bashkangjisim kësaj Kërkese për Rishqyrtim.

Poashtu cekim, se AK-QKUK, ka shpallur fitues për kët procedur pas Rivlerësimit, ndërkoh që neve si pjesëmarrës në këtë procedur prokurimi nuk na ka njoftuar fare, me këtë ka bërë shkelje tjetër ligjore.

Vendimi I AK-QKUK për eliminimin e Kompanisë tonë nga gara është bërë në shkelje me ligjin e LPP-së dhe për këtë kërkojm nga OSHP, që të bëjë shqyrtimin e lëndës dhe të vertetoj se ne jemi të përgjegjshëm, të vendoset konform kriterit për dhënie të kontratës, Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët. Vlen të ceket, se oferta jonë është gati 25% më e lirë se afërtat tjera.

Dëmet material :

Rreth 390'000.00 Euro

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë në KRPP :	06.09.2016
Lloji i procedurës së aplikuar:	Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:	shërbim/vlerë e mesme
Afati i fundit për pranim të tenderëve pas permiresimit te gabimit.....	03.10.2016
Data e hapjes së ofertave sipas procesverbalit	03.10.2016
Data e njoftimit të Dhënies së Kontratës pas ri-vleresimit në faqen e Krpp-së :	15.02.2017

Kriteret për vlerësim

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

Kërkesa 1. Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuar në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Ligji nr 04 \ L-42. LPP mund të shkarkohet nga <http://krpp.rksgov.net>.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

- Një deklaratë me shkrim nën betim e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formularin n Aneksin 2
- Dëshmi nga ATK se OE ne fjale nuk eshte me vonese per pagimin e tatimeve se paku deri ne tremujorin e fundit te vitit -Kërkohet nga tenderuesi të cilit autoriteti kontraktues ka ndër mend që t'ia jap kontratën, para publikimit të njoftimit për dhenie të kontrates (nuk e eliminon tenderuesin gjate procesit të vlerësimit). (kopje)

Dëshmi se OE ose ndonje drejtus i tij nuk eshte i denuar nga ndonje gjykate per veper penale ose gjate dy viteve te fundit eshte shpallur nga nje gjykate kompetente si i falimentuar ose likuiduar - Kërkohet nga tenderuesi të cilit autoriteti kontraktues ka ndër mend që t'ia jap kontratën, para publikimit të njoftimit për dhenie të kontrates (nuk e eliminon tenderuesin gjate procesit të vlerësimit). (kopje)

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

- Regjistrimi në regjistrin profesional, komercial dhe/apo të korporatave
- Qertifikata e TVSH-se
- Qertifikata e numrit fiskal

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

- Kopja e certifikates se biznesit
- Kopja e Certifikates se TVSH-se
- Kopja e Certifikates se numrit fiskal

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar - N/A , Dëshmia e kërkuar dokumentare: - N/A

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional

- Minimum Dy serviser te certifikuar nga prodhuesi
- Pjesët që ndërrohet duhet të jenë origjinale dhe kenë grancion 12 muaj
- Afati i reagimit të serviserit duhet të jete 2 ore prej momentit të lajmërimit .
- Dëshmi se OE ka perfunduar me sukses minimum dy kontrata te natyrës së njejtë në tri vitet e fundit : 2013,2014 dhe 2015.

Dëshmia e kërkuar dokumentare

- Te dëshmohet me Certifikatë dhe kontratë pune .
- Një Deklaratë me shkrim që pjesët që ndërrohen janë origjinale dhe kanë garancion 12 Muaj
- Deklarate me shkrim lidhur me afatin e reagimit, Origjinal e nënshkruar dhe e vulosur nga Ofertuesi.
- Listën me të cilën specifikohen të gjitha Sherbimet kryesore të rëndësishme të operatorit ekonomik të realizuara në tri vitet e shkuara, duke saktësuar sherbimet e Ofruara , shumën e kontratës, datën dhe pranuesit; (i) kur sherbimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi shërben kopja e certifikatës (certifikatave) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkë nënshkruara nga autoriteti i tillë; (ii) kur sherbimi është bërë për një blerës privat, për

Raporti i ekspertit shqyrtues për lëndën: "Servisimi dhe mirëmbajtja e rregullt e paisjeve radiologjike Lot 1,2,3,6 dhe 7", me nr. të Prokurimit: 701/16/097/211, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – "Qendra Klinike Universitare e Kosovës.

dëshmi të këtij shërbimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i shërbimit të tillë;

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr	Operatorët ekonomik	Vendi	Çmimi total për njësi €	Vërejtje
1.	“Medica”	Prishtinë	Lot 1- 179,550.00 € Lot 2- 153,600.00 € Lot 3- 148,050.00 € Lot 4- 60,850.00 € Lot 5- 137,750.00 € Lot 6- 25,330.00 € Lot 7- 25,420.00 €	JO
2.	“Medbrand”	Prishtinë	Lot 1- 207,900.00 € Lot 2- 162,500.00 € Lot 3- 126,900.00 € Lot 4- 54,900.00 € Lot 5- 124,700.00 € Lot 6- 32,800.00 € Lot 7- 33,200.00 €	JO
3.	“Eurolab”	Prishtinë	Lot 1- 214,990.00 € Lot 2- /// Lot 3- 157,991.00 € Lot 4- 151,640.00 € Lot 5- 314,890.00 € Lot 6- /// Lot 7- ///	JO
4.	“Ledi Med”	Prishtinë	Lot 1- 140,940.00€ Lot 2- 111,690.00€ Lot 3- 107,250.00 € Lot 4- 56,850.00 € Lot 5- 126,850.00 € Lot 6- 19,850.00 € Lot 7- 19,850.00 €	JO
5	“Medical Group”	Prishtinë	Lot 1- 219,000.92 € Lot 2- 179,000.00 € Lot 3- 160,000.00 € Lot 4- 127,999.98 € Lot 5- 184,237.20 € Lot 6- 32,400.00 € Lot 7- 32.400.00 €	JO

Sipas Procesverbalit të Hapjes së Tenderëve me datën: 03.10.2016, konstatohet se në hapjen e ofertave ka marrë pjesë pesë (5) përfaqësues të OE, ku është lexuar emri i operatorit ekonomik, vendi, çmimi dhe ndonjë vërejtje nëse është paraqitur. Procesverbali i hapjes është nënshkruar nga anëtarët e komisionit të hapjes pranë AK-së.

Raporti i ekspertit shqyrtues për lëndën: “Servisimi dhe mirëmbajtja e rregullt e paisjeve radiologjike Lot 1,2,3,6 dhe 7”, me nr. të Prokurimit: 701/16/097/211, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – “Qendra Klinike Universitare e Kosovës”.

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje prej tre anëtarëve, si në vijim:

- - Kryetar i komisionit – Zenel Kuqi
- - Anëtar i komisionit - Fisnik Thaqi
- - Anëtar i komisionit – Ilir Ukimeraj

Data e mbarimit të vlerësimit:28.10.2016

Data e nënshkrimit të raportit nga zyrtari kryesor i prokurimit:.....28.10.2016

Raporti i komisionit vlerësues:

OE, te rekomanduar per dhenje te kontrates sipas loteve:

Lot 1- Medica –	Prishtinë – 179.550.00 €
Lot 2- Medica –	Prishtinë – 153.600.00 €
Lot 3- Medbrand –	Prishtinë – 126,900.00 €
Lot 4- Medbrand –	Prishtinë – 54,900.00 €
Lot 5- Medbrand –	Prishtinë – 124,700.00 €
Lot 6- Medica –	Prishtinë – 25.330.00 €
Lot 7- Medica –	Prishtinë – 25.420.00 €

Komisioni Ri- vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit Ri- vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për ri-vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje prej tre anëtarëve, si në vijim:

- - Kryetar i komisionit – Sezair Ruhani
- - Anëtar i komisionit - Sahit Veseli
- - Anëtar i komisionit – Antigone Kabashi

Data e mbarimit të vlerësimit:13.02.2017

Data e nënshkrimit të raportit nga zyrtari kryesor i prokurimit:.....14.02.2017

Raporti i komisionit ri-vlerësues (te rekomanduarit per dhenje te kontrates):

OE, te rekomanduar per dhenje te kontrates sipas loteve:

Lot 1- Medica –	Prishtinë – 179.550.00 €
Lot 2- Medica –	Prishtinë – 153.600.00 €
Lot 3- Medbrand –	Prishtinë – 126,900.00 €
Lot 6- Medica –	Prishtinë – 25.330.00 €
Lot 7- Medica –	Prishtinë – 25.420.00 €

Analiza dhe sqarimet e ekspertit shqyrtues (N. 113, 114)

Eksperti shqyrtues pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Sqarimi nr.1 -

Autoriteti Kontraktues - *Qendra Klinike Universitare e Kosovës*, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është shërbim, kontratë publike me vlerë të madhe, kriter i dhënjes, tenderi i përgjegjshëm çmimi më ulët. Operatori ekonomik ankues: *"Ledi Med"*, ka parashtruar përsëri ankesë në këtë aktivitet të prokurimit kundër njoftimit për dhënie të kontratës, në lotet 1,2,3,6 dhe 7, pas ri-vlerësimit të ofertave, konkretisht kundër arsyetimit të eliminimit të theksuar në letrën standarde, të datës 13.02.2016, ku, AK - QKUK, ka cituar:

"Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye: OE ka dorëzuar dokumente ose deklarata që përmban informata përmbajtësish të gabueshme ose mashtruese. Nuk ka dëshmi se ka perfunduar me sukses dy kontratë të natyrës së njëjtë."

- 1) *Leter referenca e leshuar nga Qendra kombetare e Mjeksisë Sportive, sipas Komunikime me Z. Shkelzen Rexhaj kjo leter reference nuk është leshuar nga kjo qendër dhe nuk është nënshkruar nga Z. Rexhaj. E-mail i dt. 20.10.2016 e konfirmuar me kërkesë të OSHP-së edhe me dt. 19.01.2017. Operatori Ekonomik ka dorëzuar informata të rrejshme apo mashtruese.*

- 2) *Leter Referenca e leshuar nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës (menaxheri i kontratës 701-14-049-211) e dt. 04.04.2016 është 4 muaj para perfundimit të kontratës, perkundarzi ketu permenden defekte dytesore te cilat duhet te rregullohen dhe qe nuk janë rregulluar kurrë, Anetari i konzorciumit Siemed-turqi e konfirmon me shkrim se nuk ka qenë në dijeni për këto Defekte i njëjti gjithashtu pranon se asnje serviser i tij nuk ka qenë në Kosovë gjatë vitit 2016.*

- 3) *Ne baze te vendimit te OSHP dt. 20.01.2017 autoriteti AK ne bazë të nenin 72 të LPP-së ka kerkuar sqarim lidhur me Referencen e leshuar nga Spitali Euromed "Servisimi i paisjeve imazherike Tomografi CT Emotion me pjesë percjellëse " Spitali Euromed nuk ka kthyer përgjigje ndersa OE Ledi Med : Ka derguar një kontratë të dt. 30.01.2015 ku ceket periudha e kryerjes së shërbimeve , shuma 16.550.00 €, shuma prej 13,637.00 € e i kompenzohet OE Ledi Med me paisjen rezonance magnetike e cila ishte jashtë Funksionit ndersa vlera e mbetur 2.913.00 € i paguhet OE ledi MED kontraten me 12.10.2016. gjithashtu ka bashkangjitur referencën e Spitalit Euromed qe për dallin nga ajo qe kemi pranuar me Ofertë përveç Logos ka edhe te dhenat tjera te sitalit Euromed (e-mail, tel dhe peson kontaktues)*

- 4) *Raport Pranimi nga spitali Euromed , Z. Dardan Jakupi menaxher i Kontratës i drejtohet zyres se finacave te spitalit Euromed dhe i njofton se sherbimet janë kryer konform kontrates. dit 03.12.2015 , Sipas Autoritetit Kontraktues kjo është letër e mbrenshme e Spitalit Euromed dhe nuk ka të bëjë asgjë lidhur me kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pika 9 1 e dosjes së tenderit "*

Kundër të njëjtit arsyetim, parashtruesi i ankeses, "Ledi Med", më datën. 16.02.2017, i drejtohen AK-së me kërkesë për rishqyrtim me pretendimet ankimore se AK - QKUK, me rastin e eliminimit, pas ri-vlerësimit të ofertave, ka bërë shkelje të dispozitave të LPP-së dhe atë nenit 6, 7, 59 dhe 72, si dhe nenit 41, të UOPP-së. AK- QKUK, përmes shkresës së datës 22.02.2017, refuzon kërkesën për rishqyrtim si të pa bazuar me arsyetimin si në letër standarde.

Sqarimi nr. 2 -

Pretendimi kryesor dhe i vetëm ankimore, ka të bëjnë me arsyetimin e eliminimit të parashtruesit të ankeses pas ri-vlerësimit të ofertave, konkretisht lidhet me kërkesën e listuar në piken 9.1 pozicioni nr. 4, të FDT-së, ku AK, tekstualisht ka kërkuar: *"Dëshmi se OE ka perfunduar me sukses minimum dy kontrata të natyrës së njëjtë në tri vitet e fundit: 2013,2014 dhe 2015"*. Si dëshmi dokumentare për të njëjtën kërkesë është kërkuar: *"Listën me të cilën specifikohen të gjitha sherbimet kryesore të rëndësishme të operatorit ekonomik të realizuara në tri vitet e shkuara, duke saktësuar sherbimet e Ofruara, shumën e kontratës, datën dhe pranuesit; (i) kur sherbimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi shërben kopja e certifikatës (certifikatave) të rëndësishme të leshuar ose të bashkë nënshkruara nga autoriteti i tillë; (ii) kur sherbimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij sherbimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i sherbimit të tillë."*

Raporti i ekspertit shqyrtues për lëndën: *"Servisimi dhe mirëmbajtja e rregullt e paisjeve radiologjike Lot 1,2,3,6 dhe 7"*, me nr. të Prokurimit: 701/16/097/211, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – *"Qendra Klinike Universitare e Kosovës."*

Fillimisht sqarojme se në raportin paraprak të ekspertizës të datës **30.11.2016**, kemi sqaruar se parashtruesi i ankeses "Ledi Med", në shkresa të lëndës posedon listen e projekteve me gjithësesj **33** pozicione të përshkruara, ndërsa si dëshmi dokumentare i kemi përshkruar kopjen e referencës të datës **01.12.2015**, lëshuar sipas përshkrimit në vulë nga "Euromed" shpk për projektin me titull, "*Mirëmbajtje dhe servisim të paisjeve Imazherike – Temografi CT Emetion me pjesë përcjëllese*", për periudhën 02 shkurt deri 02 tetore 2015. Poashtu kemi përshkruar dhe kopjen e shkresës, me përshkrimin, raport i pranimi të shërbimeve të kryera, për projektin me titull, "*Mirëmbajtja dhe servisimi i aparatit të Radiologjise Siemens MR*", të datës **03.12.2015**, për periudhën 01.10.2014 deri 01.04.2015, poashtu lëshuar nga "Euromed" shpk, për të cilat shkresa, kemi vlerësuar se si të tilla e plotësojnë kërkesën e AK-së, të paraparë në pikën **9.1**, pozicioni **4**, të FDT-së.

Ndërsa referencat tjera, sipas përshkrimit lëshuar nga Sherbimi Spitalor Klinik Universitare i Kosovës, për projektin, "*Servisimi i paisjeve Radiologjike – lot 3, vlera 109,850€*", nuk e kemi përshkruar duke e cilesuar si në kundërshtim me kërkesën e AK-së, pasi që e njehta, sipas përshkrimit rezulton të jetë realizuar në 96%, (jo në tërësi siq kërkohet nga AK), të periudhes kontraktuale, me përshkrim se kanë mbetur disa defekte sekondare që duhet të riparohen. Poashtu edhe referencën tjetër të datës 11.09.2013, sipas përshkrimit, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Mjekësisë Sportive – QKMS, për projektin me titull, "*Servisimi i Paisjeve per QMRS*", me nr ref. 206-12-088-236", nuk e kemi përshkruar pasi që jemi mbështetur tek përshkrimi i numrit të prokurimit që nënkupton të jetë projekt i vitit 2012, për kundër referencës që përmban datën 11.09.2013, kërkesa e AK-së, është për projekte të realizuara në vitet 2013,2014,2015. Poashtu jemi bazuar edhe në kopjen e shkresës elektronike të datës **24.10.2016**, ku potencohet se NTSH "Ledi Med", ka bërë servisimin e paisjeve në qendrën e mjekësisë kombëtare sportive, por leter reference nuk i kemi lëshuar asnjehere kësaj kompanie, andaj të njejtat i kemi cilesuar si referenca që nuk e plotësojnë kërkesën e AK-së.

Mirëpo parashtruesi i ankesës bashkangjitur në ankësë posedon kopjen e shkresës elektroike –e-mailit, sipas përshkrimit e datës 15.02.2017, dhëne nga e njehta adresë shkelzenrexhaj@hotmail.com, dhe për të njejtin projekt, dërguar tek: ledimed.office@gmail.com, CC: rushiti_29@hotmail.com, me përshkrimin si në vijim: "...Siq e kamë cekur edhe në shkresat paraprake lidhur më këtë qështje, kompania "Ledi Med", ka kryer shërbime dhe furnizime të ndryshme për qendrën tonë, sipas kontratave me MSH, mes tyre është edhe shërbimi që ju keni cekur "Servisimi i paisjeve në QMRS", me ref nr. 206-12-088-236. Shkresa – "Referenca" të cilën ma keni dërguar kopje në këtë e-mail, e njehta më është prezantuar edhe nga organet e hetuesisë, andaj siq jamë deklaruar në hetuesi edhe tani konfirmoj se: Shkresa – Referenca" në fjalë për projektin e cekur me lartë është lëshuar nga qendra jonë".

Megjithatë vendimi i OSHP-së kundrejt ankesës paraprake të të njejtit ankues, ka oblikuar AK-në që me rastin e rivlerësimit të ofertave të veproj në pajtim me nenin 72, të LPP-së, lidhur me referencat e OE ankues dhe përgjegjëshmërinë e këtij OE, me theks të veçantë i njejtë vendim potencon referencat e leshuara nga "Euro Med", konkretisht arsyetimi i vendimit thekson se paneli shqyrtues, nuk pati provë apo fakt që e dëshmon të kundërtën dhe për kundër se të njejtat nuk përmbajnë të dhëna të mjaftueshme për ta aprovuar apo jo një referencë të tillë.

Kundrejtë të njejtë vendim, vlerësimi ynë është që letra standarde, gjegjësisht arsyetimi i eliminimit të parashtruesit të ankesës, pas ri-vlerësimit të ofertave, nuk përmban të dhëna konkretë, nëse e plotësojnë apo jo, kërkesën e AK-së, referencat, pjesë e ofertës së parashtruesit të ankesës.

Raporti i ekspertit shqyrtues për lëndën: "*Servisimi dhe mirëmbajtja e rregullt e paisjeve radiologjike Lot 1,2,3,6 dhe 7*", me nr. të Prokurimit: 701/16/097/211, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – "*Qendra Klinike Universitare e Kosovës*".

- AK- QKUK, lidhur me referencat e pershkuara në pikën 3, të letrës standarde - “Servisimi i paisjeve imazherike Tomografi CT Emotion me pjesë percjellëse“, potencon se spitali “Euromed”, nuk ka kthyer përgjigje, ndërsa OE “Ledi Med”, ka derguar një kontratë të dt. 30.01.2015, ku ceket se shuma prej 13,637.00, i kompenzohet OE “Ledi Med”, me paisjen rezonancë magnetike, ndërsa vlera e mbetur prej 2.913.00 € i paguhet, rrjedhimisht të njejtën referencë e kualifikon si të pa pranueshme kundrejt kërkesës, vleresimi ynë është që arsyetimi si i tillë nënkupton se AK - QKUK, nuk i ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për verifikim – sqarim, gjatë rivlerësimit të ofertave, sipas rekomandimeve të dhëna në vendimin nr. 402/16, të datës 17.01.2017, të OSHP-së, pasi që AK-së, në pikën 9.1, të FDT-së ka kërkuar nga OE-të, minimumi dy (2) kontrata të natyrës së njejtë, të realizuara në tri vitet e fundit, duke kërkuar shumën e kontratës, **por pa e precizuar minimumin e ndonjë vlere monetare.**
- Poashtu arsyetimi tjetër i eliminimit i përshkruar në pikën 4, të letrës standarde, dhe potencomi se “Raport Pranimi” nga spitali “Euromed”, është letër e mbrenshme e spitalit “Euromed” dhe nuk ka të bëjë asgjë lidhur me kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pika 9.1 e dosjes së tenderit. Eksperti shqyrtues poashtu vlereson se sqarimi si i tillë nënkupton se AK, nuk i ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për verifikim – sqarim, gjatë rivlerësimit të ofertave, sipas rekomandimeve të dhëna në vendimin nr. 402/16, të datës 17.01.2017, të OSHP-së, për faktin se AK, për kërkesën e pikës 9.1, të FDT-së, si dëshmi dokumentare ka kërkuar: “... ii) kur shërbimi është bërë për një blerës privat, **për dëshmi të këtij shërbimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i shërbimit të tillë**”, në shkresën e njejtë potencohet se spitali “Euromed”, ka nënshkruar kontratë me kompanin “Ledi Med”, dhe se punet janë përfunduar konform kontratës.

Ndërsa lidhur me pohimet e potencuara, kundrejt shkresave të ofertës të potencuara për referencat e përshkuara në pikën 1 dhe 2, të letrës standarde se parashtruesi i ankesës ka dorezuar deklarata që përmbajnë informata përmbajtësisht të gabueshme ose mashtruese dhe përshkrimi tjetër për referencën tjetër, se anëtarë i konzorciumit ‘Siemed’ – Turqi e konfirmon me shkrim se nuk ka qenë në dijeni për defekte dhe se njejtë ka pranuar se asnjë serviser i tij nuk ka qenë në Kosovë gjatë vitit 2016. Për të njetën situatë, eksperti shqyrtues sqaron se parashtruesi i ankesës, “Ledi Med”, pikërsht për këtë aktivitet të prokurimit, ka të plotësuar aneksin 2, të dosjes së tenderit duke nënshkruar dhe vulosur deklarate nën betim, përmes të cilës deklararon përshtatshmerin në përputhje me nenin 65, të LPP-së, konkretisht pranon mundësin e sanksioneve penale dhe civile, gjobave dhe denimeve, sipas përshkrimit nëse i njejtë dorëzon çfardo dokumenti ose deklarate që përmban informata përmbajtësisht të gabueshme apo mashtruese, rrjedhimisht edhe përgjegjësia bie mbi barren e tij, Ndërsa potencimi për defekte apo servertet, për të njëjtat situata dispozita e nenit 63 dhe 65 të LPP-së, i qartësojnë qështjet e tilla.

- Andaj eksperti shqyrtues sipas përgjegjësisë (nenit 114, i LPP-së), sqaron se çdo shkresë e lëndës cilesohet valide, përderisa nuk është vërtetuar e kundërta nga organet kompetente. Për më tepër neni 65, paragrafin 3, i LPP-së, në fuqi, sqaron kur një OE, **nuk ka të drejtë që të marr pjesë në një aktivitet të prokurimit, ose në ekzekutimin e një kontrate publike, konkretisht nënparagrafi 3.2, shprehimisht thotë: “është deklaruar i papërshtatshëm, kur autoriteti kontraktues zbulon se kjo është një shkelje e rëndë profesionale e konstatuar nga një gjykatë kompetente**”. Poashtu nënparagrafi 3.5 dhe 3.6, i të njetit nen citon: **“është konstatuar nga një gjykatë kompetente, agjenci administrative ose organizatë për zbatimin e**

Raporti i ekspertit shqyrtues për lëndën: “Servisimi dhe mirëmbajtja e rregullt e paisjeve radiologjike Lot 1,2,3,6 dhe 7”, me nr. të Prokurimit: 701/16/097/211, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – “Qendra Klinike Universitare e Kosovës.

standardeve të sjelljes profesionale, se është sjellë në mënyrë joprofesionale; ose është konstatuar nga një gjykatë kompetente se ka bërë keqinterpretime para autoriteteve publike në Kosovë ose diku tjetër". Sipas shkresave të lëndës nuk kemi hasur, në ndonjë shkresë zyrtare se i njejtë është deklaruar i pa përshtatshëm sipas dispozitave të paragrafit 3, të nenit 65, në fuqi.

Perfundimishtë, në mbështetje të të gjeturave dhe sqarimeve kundrejt pretendimeve ankimore të përshkruara më lartë, si dhe në mbështetje të nenit 1, 6 dhe 7, të LPP-së, rekomandimi ynë për AK-në, është që loti 1,2,3,6 dhe 7, të këtijë aktiviteti i prokurimit të kthehen në ri-vlerësim dhe të kemi një pasqyrë reale kundrejt shkresave - pjesë e dosjes së parashtruesit të ankesës nëse të njejtë i përgjigjen kërkesës së parapare në piken 9.1, pozicioni 4, i FDT-së, konkretisht sipas rekomandimeve të dhëna nga paneli shqyrtues përmes vendimit të datës 17.01.2017, me nr. 402/16.

Mendimi i ekspertit shqyrtues :

- Eksperti shqyrtues bazuar në sqarimet e cekura në raport i propron panelit shqyrtues që lotin 1,2,3,6 dhe 7, të aktivitetit të prokurimit me titull: **"Servisimi dhe mirëmbajtja e rregullt e paisjeve radiologjike"**, me nr prok. 701/16/097/211, t'i kthej në **RI VLERESIM**.
- Gjithashtu eksperti shqyrtues rekomandon panelin shqyrtues që të aprovoj ankesën e operatorit ekonomik **"Ledi Med"** shpk, si të bazuar.